

Fondi Slloveno Kosovar i Pensioneve

Fondi 1

PASQYRAT FINANCIARE

PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2015

ME RAPORTIN E AUDITORIT TË PAVARUR

Përmbajtja

	Faqe
Raporti i Auditorit të Pavarur	
Pasqyra e pasurive neto e Fondit 1	1
Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve	2
Pasqyra e ndryshimeve në pasuritë neto të Fondit 1	3
Treguesit financiarë të njësive llogaritëse	4
Pasqyra e njësisë së kontabilitetit	5
Shënimet për pasqyrat financiare	6-19



Building a better
working world

Ernst & Young Certified Auditors Ltd -
Kosovo
Str Pashko Vasa 16/7
Prishtine, Kosova

Tel +381 38 220 155
Fax +381 38 220 155
ey.com

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR*

Për Menaxhmentin dhe Themeluesit e Fondit Sllloveno Kosovar të Pensioneve - Fondi 1

Ne kemi audituar pasqyrat financiare përcjellëse të Fondit Sllloveno Kosovar të Pensioneve - Fondi 1 (më tej referuar si "Fondi 1") për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015, që përbëhet nga Pasqyra e pasurive neto të Fondit 1, Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve, Pasqyra e Ndryshimeve në Pasuritë neto të Fondit 1, Treguesit financiarë të njësive llogaritëse, si dhe një përmbledhje të politikave kryesore kontabël dhe shënimet tjera sqaruese.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me rregullat dhe rregulloret e Bankës Qendrore të Kosovës të zbatueshme për fondet pensionale ("Rregullat e BQK") në Kosovë, siç janë përcaktuar në shënimin 2, dhe për kontrollin e tilla të brendshme që menaxhmenti përcakton se është e nevojshme të mundësojë përgatitjen e pasqyrave financiare që janë të lira nga gabimet materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose te gabimeve.

Përgjegjësitë e Auditorit

Përgjegjësia jonë është të shprehim opinionin për këto pasqyrat financiare në bazë të auditimit tonë. Ne kemi kryer auditimin tonë në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Ato standarde kërkojnë që ne të përmbushim kërkesat etike dhe që të planifikojmë dhe kryejmë auditimin për të fituar siguri të mjaftueshme që pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi për shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura janë në gjykimin e auditorit, duke përfshirë vlerësimin e rrezikut të keq-deklarimeve materiale, qoftë si rezultat i mashtrimeve apo gabimeve. Gjatë vlerësimit të këtyre rreziqeve, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare të shoqërisë për të dizajnuar procedurat e auditimit që janë të duhura në ato rrethana, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit për efektivitetin e kontrollit të brendshëm të shoqërisë. Auditimi përfshin edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël që përdoren dhe arsyeshmërisë së vlersimeve të kontabilitetit të kryera nga menaxhmenti, si edhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se dëshmitë e auditimit që ne kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për të dhënë bazë për opinionin tonë të auditimit.

Opinionit

Sipas mendimit tonë, pasqyrat financiare të Fondit 1 më dhe për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015 janë përgatitur nga të gjitha aspektet materiale, në përputhje me rregullat e BQK-së siç është përcaktuar në shënimin 2 të pasqyrave financiare.

Ernst & Young Certified Auditors Kosovo

Ernst & Young Certified Auditors Kosovo sh.p.k
29 mars 2016

* Ky raport është përkthim i versionit original në anglisht, në rast të mospërputhjes do të mbizotërojnë versioni në gjuhën angleze.

FONDI SLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE - FONDI 1

PASQYRA E PASURIVE NETO E FONDIT 1

më 31 dhjetor 2015

(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

	Shënimet	Më 31 dhjetor 2015	Më 31 dhjetor 2014
Pasuritë			
Paraja dhe ekuivalentët e saj	5	172,560	116,418
Investimet në dispozicion për shitje	6	5,146,924	4,628,744
Investimet e mbajtura deri në maturim	7	330,306	741,788
Të arkëtueshmet tjera		5,020	180
Gjithsej pasuritë		5,654,810	5,487,130
Detyrimet dhe fondet e pjesëmarrësve			
Detyrimet			
Detyrimet për tarifën e menaxhimit		9,608	8,412
Detyrimet për ndarjen e fitimit	8	7,356	38,519
Detyrimet tjera		223	243
		17,187	47,174
Fondet e pjesëmarrësve dhe rezervat teknike			
Pasuritë neto të Fondit 1		5,629,810	5,204,035
Teprica për vitin		7,813	235,921
		5,637,623	5,439,956
Gjithsej detyrimet dhe fondet e pjesëmarrësve		5,654,810	5,487,130
Njësitë e llogaritjes të emetuara		38,790.8825	37,499.1535
Vlera e njësisë së llogaritjes		145.3337	145.0688

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga Menaxhmenti i Fondi Sloveno Kosovar i Pensioneve – Fondi 1 më 21 mars 2016 dhe janë nënshkruar në emër nga,

Z. Bajram Bajrami,
Drejtor menaxhues

Pasqyrat e pasurive neto të Fondit 1 duhet lexuar së bashku me shënimet e paraqitura në faqet 6 deri 19, duke formuar një pjesë integrale të pasqyrave financiare.

Pasqyrat Financiare së bashku me Shënimet përcjellëse janë përkthim i versionit origjinal në anglisht, në rast të mospërputhjes do të mbizotërojë versioni në gjuhën angleze.

FONDI SLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE - FONDI 1

PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015 (vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

	Shënimet	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Të ardhurat			
Të ardhurat nga interesi	9	163,839	198,033
Të ardhurat e realizuara nga shitja/maturimi i investimeve	10	25,807	28,473
Të ardhurat nga dividenda		35,443	15,170
Të ardhurat nga këmbimi valuator i artikujve monetar		18,300	4,836
Të ardhurat tjera		3,603	1,444
		246,992	247,956
Shpenzimet			
Tarifa e menaxhimit		(84,998)	(79,061)
Shpenzimet për ndarjen e fitimit	8	(7,356)	(38,519)
Tarifa e provizionit dhe transaksioneve		(21,099)	(8,901)
Humbjet e realizuara nga investimet		(11,684)	(6,822)
Humbja nga këmbimi valuator i artikujve monetarë		(25,782)	(2,722)
		(150,919)	(136,025)
Neto e ardhura nga investimet		96,073	111,931
E ardhura e perealizuar			
Fitimet e perealizuara nga letrat me vlerë në dispozicion për shitje, neto		(159,330)	91,138
Ndryshimet në këmbimin valutor të investimeve në investime		71,070	32,852
		(88,260)	123,990
Teprica neto e Fondit 1 për vitin		7,813	235,921

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve të Fondi 1 duhet lexuar së bashku me shënimet e paraqitura në faqet 6 deri 19, duke formuar një pjesë integrale të pasqyrave financiare.

FONDI SLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE - FONDI 1

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË PASURITË NETO TË FONDI 1 për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015 (vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

Shënimet	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Fitimi neto nga investimet	96,073	111,931
Fitimet e përealizuara	(88,260)	123,990
Teprica neto e Fondit 1 për vitin	7,813	235,921
Kontributet e marra nga Pjesëmarrësit	447,748	439,830
Pensionet e paguara	(257,893)	(237,390)
Rritja nga njësitë të faturimit	189,855	202,440
Gjithsej rritja në pasuritë neto	197,668	438,361
Pasuritë neto më 1 janar	5,439,956	5,001,595
Pasuritë neto më 31 dhjetor	5,637,624	5,439,956
Numri i njësive të kontrollit të faturimit	1,291.7290	1,402.3396

Pasqyra e ndryshimeve në pasuritë neto të Fondi 1 duhet lexuar së bashku me shënimet e paraqitura në faqet 6 deri 19, duke formuar një pjesë integrale të pasqyrave financiare.

FONDI SLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE - FONDI 1

TREGUESIT FINANCIARË TË NJËSIVE LLOGARITËSE për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015 (vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Njësitë llogaritëse në fillim të vitit	37,499.15	36,096.8139
Vlera e njësive llogaritëse në fillim të vitit	145.0688	138.5606
Pasuritë neto të fondit të pensioneve në fund të vitit	5,637,623	5,439,956
Numri i njësive llogaritëse në fund të vitit	38,790.88	37,499.1535
Vlera e njësive llogaritëse në fund të vitit	145.3337	145.0688

FONDI SLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE - FONDI 1

PASQYRA E NJËSIVE LLOGARITËSE për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015 (vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

Përshkrimi	Numri i njësive të llogaritjes	Vlera e pasurive neto
Njësitë llogaritëse në fillim të vitit	37,499.1535	5,439,956
Njësitë llogaritëse të emetuara gjatë vitit - kontributet	3,019.0541	447,748
Njësitë llogaritëse të emetuara gjatë vitit – transferet në fondet tjera	-	-
Reduktimi i njësive llogaritës për shkak të transfereve në Fondi 2	(7.3742)	-
Reduktimi i njësive llogaritës për shkak të pagesave të benefiteve	(1,719.9506)	(257,894)
Reduktimi i njësive llogaritës për shkak të pagesës së tarifës nga pasurit neto të Fondi 1	-	-
Rritja neto nga operacionet		7,813
Gjithsej numri i njësive llogaritëse në fund të vitit	38,790.8800	5,637,623
Vlera e njësisë së llogaritjes		
Në fillim të vitit	145.0688	
Në fund të vitit	145.3337	

FONDI SLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE - FONDI 1

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015

1. INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME

Fondi Sloveno Kosovar i Pensioneve Sh.a. (më tej referuar si "Kompania" ose "FSKP") është themeluar si shoqëri aksionare më 29 gusht 2006 me numër të regjistrimit të biznesit 70378739. Kompania ka filluar operimin e saj që nga data 04 shtator 2006. Kompania gjendet në Rr.UCK, nr.50/2, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës.

Ligji nr. 03/L-084 për ndryshimin e rregullores së UNMIK-ut 2005/20 mbi pensionet në Kosovë nën të cilin është themeluar Fondi Sloveno Kosovar i Pensioneve – Fondi 1, parashikon mbi programin suplementar e kursimeve pensionale, të themeluar nga kontributet pensionale të të punësuarit dhe punëdhënësit. Secili pjesmarrës vullnetar ka Llogarinë Individuale në Fondin 1, në të cilën kreditohen kontributet.

Fondi 1 administrohet dhe menaxhohet nga Kompania – FSKP. Aksionarët kryesorë të Kompanisë janë Prva Group PLC, Slovenia dhe Korporata Dukagjini, Republika e Kosovës.

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL

Politikat themelore të kontabilitetit të cilat janë adaptuar në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare janë të paraqitura më poshtë. Këto politika janë aplikuar në vazhdimësi në të gjitha vitet e prezentuara, përveç nëse caktohet ndryshe.

2.1 Deklarata e përputhshmërisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhshmëri me rregullat dhe rregulloret e Bankës Qëndrore të Republikës së Kosovës të cilat zbatohen për fondet pensionale ("Rregullat e BQK-së") të cilat janë të bazuara në njohjen dhe matjen e kriterëve të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF").

2.2 Bazat e përgatitjes

Këto pasqyra financiare janë përgatitur duke përdorur politikat e rëndësishme kontabël dhe bazat e matjes të përmbledhura më poshtë që janë në përputhje me rregullat e BQK-së. Këto politika janë aplikuar në vazhdimësi në të gjitha vitet e paraqitura, përveç nëse caktohet ndryshe.

Këto pasqyra financiare duhet të lexohen ashtu siç janë përgatitur në përputhshmëri me standardet dhe rregulloret kontabël që mbizotërojnë në Kosovë, duke iu referuar politikave kontabël të vëna më poshtë, dhe nuk duhet të lexohen ose konsiderohen si pasqyra financiare të përgatitura në përputhshmëri me SNRF.

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Euro, monedha e Bashkimit Evropian.

2.3 Paraja dhe ekuivalentet e saj

Paraja dhe ekuivalentet e parasë, përfshijnë balancat me bankat për pagesat e kontribuesve pensional si dhe për qëllime të investimeve, barten në kosto.

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**2.4 Pasuritë financiare****Politikat e vlerësimit dhe klasifikimit**

Fondi ka vendosur politikat e tij kontabël në përputhje me rregullat e BQK-së. Rregulla N.6 "Mbi Fondin Pensional dhe vlerësimin e Fondit Pensional" krijon udhëzime të përgjithshme të klasifikimit dhe vlerësimit të pasurive të mbajtura nga kompanitë e pensioneve. Sa i përket instrumenteve financiare, neni 4.2 i rregullores nr. 6 përcakton parimet dhe udhëzimet e mëposhtme.

- Investimet në letrat me vlerë të kapitalit janë matur me vlerën e drejtë.
- Letrat me vlera afatshkurtra në vlerën e realizushme neto, ndërsa borxhi afat-mesëm ose afat-gjatë me koston e amortizuar.
- Letrat me vlerë të Qeverisë janë matur me koston e amortizuar.
- Letrat me vlerë të blera në tregjet aktive janë vlerësuar në bazë të vlerave përkatëse të realizushme në datën e vlerësimit.

BQK-ja mund të lejoj bazat e tjera të vlerësimit të cilat janë në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare për fondet pensionale që janë të përcaktuara nga OECD ose vendet e BE-së apo të pranueshme nga SNRF. Menaxhmenti i Fondit 1 ka përcaktuar se matja në vlerën e drejtë është metodologjia e përdorur gjerësisht për vlerësimin e pasurive pensionale, kur vlera e drejtë mund të matet në mënyrë të besueshme, siç është rasti i kapitalit të cituar dhe letrat me vlerë të borxhit.

Si rrjedhojë në vitin aktual, Fondi 1 ka riklasifikuar letrat e kuotuar me vlerë të borxhit nga vlerësimi i koston së amortizuar për vlerësimin e vlerës së tregut. Diferenca e vlerës së drejtë në shumën bartëse në datën e riklasifikimit, është njohur në të ardhurat e vitit.

Klasifikimi dhe riklasifikimi i instrumenteve financiare

Pas njohjes fillestare, Fondi 1 i klasifikon pasuritë financiare në kategoritë në vazhdim: në vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes që përfshijnë huatë dhe të arkëtueshmet të mbajtura për maturim dhe në dispozicion për shitje. Klasifikimi varet nga qëllimi për të cilin pasuritë financiare janë përvetësuar.

Rregulloret e BQK-së nuk kanë ndonjë rregull për riklasifikim; megjithatë, menaxhmenti i ndjek parimet e pranuar gjerësisht se klasifikimi duhet të jetë përgjithësisht i qëndrueshëm në kohë, dhe riklasifikimet janë bërë me qëllim të përmirësimit të besueshmërisë së pasqyrave financiare. Për shembull riklasifikimi i letrave me vlerë të borxhit në dispozicion për shitje e ka eliminuar paqartësitë nga rënia në vlerë e portfolin e mbajtur në maturim.

Pasuritë financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes

Pasuritë financiare në vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes janë pasuri financiare në dispozicion për shitje dhe ato të përcaktuara në vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes në fillim. Pasuria financiar klasifikohet në këtë kategori nëse kërkohet kryesisht për qëllime të shitjes në periudhë afatshkurtër ose nëse është e përcaktuar ashtu nga menaxhmenti. Pasuritë në këtë kategori klasifikohen si pasuri qarkulluese.

Huatë dhe të arkëtueshmet

Huatë dhe të arkëtueshmet janë pasuri financiare jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktuara që nuk janë kuotuar në tregun aktiv. Ato janë të përfshira në pasuri qarkulluese, përveç për maturim më të gjatë se 12 muaj pas datës së pozicionit financiar. Këto klasifikohen si pasuri jo-qarkulluese. Huatë dhe të arkëtueshmet e Fondit 1 përbëjnë "të arkëtueshmet tregtare dhe të arkëtueshme tjera", depozitat në banka dhe paraja dhe ekuivalentet e parasë në pozicionin financiar.

Pasuritë financiare në dispozicion për shitje

Pasuritë financiare në dispozicion për shitje janë pasuri jo-derivative që ose janë përcaktuar në këtë kategori ose nuk janë klasifikuar në ndonjë kategori tjetër. Janë të përfshira në pasuri jo-qarkulluese përveç nëse menaxhmenti ka ndërmend ti heqë investimet brenda 12 muajve nga data e pozicionit financiar. Fondi 1 nuk ka pasuri të klasifikuara në këte kategori.

Pasuritë financiare të mbajtura deri në maturim

Investimet e mbajtura deri në maturim janë pasuri financiare jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktueshme dhe me maturimet fikse që menaxhmenti i Fondit 1 ka qëllim pozitiv dhe aftësi ti mbaj deri në maturim. Kur Fondi 1 ka ndërmend të shesë përveç ndonjë shume të vogël të pasurive të mbajtura deri në maturim, e tërë kategoria do të prishet dhe do të riklasifikohet si në dispozicion për shitje.

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

2.4 Pasuritë financiare (vazhdim)

Njohja fillestare, matja dhe mosnjohja

Blerjet dhe shitjet e rregullta të pasurive financiare njihen në datën e tregëtimit – data në të cilën Fondi 1 zotohet të blejë apo shesë pasurinë. Investimet fillimisht janë njohur në vlerën reale plus kostoja e transaksionit për të gjitha pasuritë financiare që nuk janë bartur në vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes.

Pasuritë financiare të bartura në vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes fillimisht janë njohur në vlerën e drejtë dhe kostot e transaksionit janë shpenzuar në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Pasuritë financiare janë hequr kur e drejta për të pranuar rrjedhë të parase nga investimet ka skaduar ose është transferuar dhe Fondi 1 ka transferuar kryesisht të gjitha risqet dhe shpërblimet e pronësisë.

Pasuritë financiare në dispozicion për shitje (nëse janë mbajtur) dhe pasuritë financiare në vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes janë bartur më pas në vlerë të drejtë. Huatë dhe të arkëtueshmet janë bartur në kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interest efektiv.

Të hyrat e porealizuara të interest dhe amortizimi i zbritjes/(primit) janë njohur si e hyrë dhe shpenzim për periudhën.

Fitimet nga dividenda dhe fitimet apo humbjet nga ndryshimet në vlerën e drejtë të kategorisë së "pasurive financiare në vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes" janë njohur si të ardhura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në periudhën në të cilën ato rrjedhin.

Ndryshimet në vlerën e drejtë të letrave me vlerë momentare dhe jo-momentare të klasifikuara si në dispozicion për shitje (nëse janë mbajtur) janë njohur në ekuitet. Kur letrat me vlerë të klasifikuara si në dispozicion për shitje janë shitur ose dëmtuar, rregullimet e vlerës së drejtë të akumuluar që janë njohur në ekuitet janë përfshirë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve si "fitim apo humbje nga letrat me vlerë të investimit".

Interesi mbi letrat me vlerë në dispozicion për shitje i llogaritur duke përdorur metodën e interest efektiv është njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve si pjesë e të ardhurave të tjera. Dividentët mbi instrumentët e ekuitetit në dispozicion për shitje janë njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve si pjesë e të hyrave tjera kur është përcaktuar e drejta e Fondit 1 për të pranuar pagesat.

Vlerat reale të investimeve të kuotuar janë bazuar në çmimet aktuale të ofertimit. Nëse tregu për një pasuri financiar nuk është aktiv (dhe për letra me vlerë të pa listuara), Fondi 1 përcakton vlerën reale duke përdorur teknikat e vlerësimit.

Dëmtimi i pasurive financiare

Fondi 1 vlerëson në secilën datë të bilancit nëse ka dëshmi objektive se një pasuri financiar ose grup i pasurive financiare janë dëmtuar. Në rastin e letrave me vlerë të ekuitetit të klasifikuara si në dispozicion për shitje, një rënie e rëndësishme ose e tejzgatur në vlerën reale të letrës me vlerën nën koston e saj konsiderohet si indikator se është dëmtuar. Nëse një dëshmi e tillë ekziston për pasuritë financiare në dispozicion për shitje, humbja kumulative – e matur si ndryshim ndërmjet çmimit të përvetësimit dhe vlerës reale aktuale, minus provisioni për humbjen e dëmit mbi pasurin financiar më parë të njohur në fitim dhe humbje – është hequr nga ekuiteti dhe njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Humbjet e dëmtimeve të njohura në pasqyrën e të ardhurave tek instrumentët e ekuitetit nuk janë kthyer përmes pasqyrës së të ardhurave. Testimi i dëmtimit të arkëtueshmeve tregtare është përshkruar më tej në këtë shënim.

2.5 Të arkëtueshmet dhe të pagueshmet në lidhje me letrat me vlerë të investimit

Të arkëtueshmet dhe të pagueshmet lindin nga blerja dhe shitja e letrave me vlerë dhe njihen si pasuri dhe/ose detyrime në datën e transaksionit të bërë.

FONDI SLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE - FUND 1

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

2.6 *Pasuritë neto të Fondit 1*

Vlera neto e pasurive të Fondit 1 është e barabartë me gjithsej pasuritë minus gjithsej detyrimet të Fondit 1.

2.7 *Vlera e njësisë së llogaritjes*

Vlera e njësisë së llogaritjes barazohet me vlerën e pasurive neto të Fondit të pjestuara nga gjithsej numri i njësive të llogaritjes në datën e llogaritjes. Kjo formulë nuk aplikohet për ditën e parë të operacioneve kur vlera e njësisë së llogaritjes barazon me 100 Euro në pajtueshmëri me politikën e Fondit.

2.8 *Të hyrat nga interesi*

Të hyrat nga interesi përfshijnë të hyrat nga normat e kuponëve të obligacioneve dhe interesi mbi depozitat me afat. Të hyrat e interesit janë regjistruar në baza akruale.

2.9 *Tarifa e menaxhmentit*

Fondi është i obliguar të paguajë tarifën e menaxhimit Kompanisë në baza ditore. Tarifa vjetore e menaxhmentit është 1.5 % të gjithsej pasurive të Fondit.

2.10 *Shpenzimet për tarifën e transaksionit*

Këto shpenzime lidhen me tarifën e paguar ndërmjetësuesve financiarë (bankave dhe komisionerëve) që sigurojnë letra me vlerë të investimeve për Fondin 1.

2.11 *Fitimi/humbja e realizuar*

Fitimet/humbjet e realizuara dalin nga shitja e letrave me vlerë, nivelizimi i çmimeve kur letrat me vlerë janë siguruar dhe kapitali i maturuar dhe interesi për letrat me vlerë janë siguruar në prime ose zbritje. Këto fitime/humbje janë regjistruar në të ardhura ose shpenzime kur ato ndodhin.

Fitimet ose humbjet që rrjedhin kur investimet janë shitur ose kanë maturuar paraqiten si "të realizuara" në pasqyrën e të ardhurave, ndërsa fitimet ose humbjet që vijnë në vlerësimin e investimeve të mbajtura paraqiten veçmas si "të perealizuara" në pasqyrën e të ardhurave.

2.12 *Amortizimi i zbritjes/primit i letrës me vlerë*

Amortizimi i diskontit/primit të letrës me vlerë është regjistruar përmes të ardhurave/shpenzimeve të shtyra dhe shpenzimeve/të ardhurave akruale. Në momentin kur letra me vlerë është maturuar apo shitur, shuma e amortizuar është transferuar si fitim ose humbje e realizuar kapitale.

2.13 *Fitimi/humbja nga këmbimi valutor*

Transaksionet në valutën e huaj janë regjistruar në pajtueshmëri me normat e vlefshme të këmbimit në datën e transaksionit. Ndryshimet janë regjistruar në pasqyrën e të ardhurave si fitim/humbje.

Diferencat e këmbimit valutor që rrjedhin nga raportimi në datën vlerësimit të parasë të gatshme dhe ekuivalenteve të saj dhe diferencës që rrjedh nga shitja e investimeve raportohen ndaras në pasqyrën e të ardhurave si "të realizuara". Diferencat e këmbimit valutor që rrjedhin nga raportimi në datën përkthimit të investimeve të mbajtura raportohen ndaras në pasqyrën e të ardhurave si "të perealizuara".

2.14 *Transaksionet me palët e lidhura*

Palët e lidhura janë definuar si ato palë të cilat kanë kontroll mbi njëra tjetrën ose kanë ose që mund të kenë ndikim në vendimet financiare dhe operacionale të njëra tjetrës.

Palët e lidhura të Fondit janë Prva Group PLC nga Ljubljana, Sllovenia dhe Korporata Dukagjini nga Peja, Republika e Kosovës, të cilët menaxhojnë dhe administrojnë Fondin 1 dhe Kompaninë.

FONDI SLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE - FUND 1

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015

3. PASURITË E FONDIT 1 DHE STRATEGJIA E INVESTIMIT

Fondi 1 është i obliguar të ndjekë rregullat e BQK-së në lidhje me investimet në lloje të ndryshme të pasurive financiare dhe shumat e investimeve në këto pasuri.

Siç përshkruhet nga Rregulla 9 mbi Investimet e Pasurive Pensionale, pasuese e dispozitave të Ligjit nr. 03/L-084 mbi ndryshimin e rregullores së UNMIK-ut nr. 2005/20, Fondi 1 duhet të përmbushë kushtet e përgjithshme në vazhdim:

- a. Fondi duhet të investojë pasuritë e tij vetëm në klasët e investimeve të lejuara (të pranueshme) të parashikuara sipas kësaj rregulle ose në para të deponuara te kujdestari ose për paratë dhe depozitat bankare që paraqesin shumat që janë arsyeshëm të nevojshme për të zhvilluar operimet e tij pensionale.
- b. Pranueshmëria e investimit përcaktohet në kohën e blërjes së tij ose përvetësimit. Nëse përcaktimi i pranueshmërisë është i bazuar në shumën, kufizimi bazohet në shumën e gjithsej pasurive të investimit sipas datës së fundit të vlersimit të pasurive, që është raportuar në BQK.
- c. Investimet e pasuriveve pensionale duhet të jenë në pajtueshmëri me deklaratën e parimeve të investimeve dhe konform me direktivat e investimit të përshtatura dhe të lëshuara nga entiteti i pensionit në pajtim me kërkesat e Rregullores së Pensioneve dhe këto Rregulla.
- d. Investimet e bëra duke thyer dhe shkelur parimet dhe direktivat e investimit duhet të përmirësohen menjëherë. Shkeljet dhe devijimet, të investimeve të mëparshme të konfirmuara, që vijnë nga shkakut ose shkaqet përtej kontrollit të bordit të drejtorëve ose menaxherit të pasurive pensionale mund të përmirësohen për një kohë të tillë dhe mënyrë që është më pak e dëmshme për interesin e pjesëmarrësve ku periudha kohore nuk është më shumë se 6 muaj nga data e shkeljes apo devijimit.
- e. Organet drejtuese të entiteteve pensionale që sigurojnë pensione duhet të dorëzojnë në BQK së bashku me raportet tremujore dhe vjetore, deklaratën e vërtetuar nga një zyrtar i autorizuar, duke vërtetuar se të gjitha pasuritë e investuara të entitetit janë në pajtueshmëri me kushtet, ndalesat dhe kufizimet e parashtruara në Rregulloren e Pensioneve dhe në këtë rregull dhe konform deklaratës së parimeve të investimit dhe direktivat e investimit të adoptuara nga entiteti; duke siguruar se, nëse ndryshe, deklarata e vërtetuar duhet qartë të tregojë natyrën e kundërvajtjes, shkeljes ose devijimit, duke identifikuar veqanërisht investimet e pasurive jo në pajtueshmëri dhe duke përshkruar mënyrën dhe afatin kohor dhe/ose përmirësimin.

Siç këshillohet nga Rregulla 9, Fondi 1 duhet të ndjekë dhe të përmbushë kushtet specifike në vazhdim:

- a. Në çdo kohë, investimet e pasurive pensionale janë temë e kushteve specifike në vazhdim:
 - Fondet apo aksionet e ekuitetit nuk duhet të jenë më të mëdha se 5 % e gjithsej aksioneve të emetuara nga një emetues.
 - Obligimet nuk duhet të jenë më të larta se 30% të çfarëdo emetimi të vetëm të obligacionit.
 - Gjithsej investimet në çdo entitet, përfshirë edhe entitetin e tij të bashkuar, nuk duhet të jenë më të larta se 5% të gjithsej pasuriveve pensionale.
- b. Për mbrojtje të mëtutjeshme të kualitetit të pasurive pensionale, BQK kohë pas kohe mund të këshillojë shkallët minimale të investimit ose klasifikimit të letrave me vlerë në përcaktimin e pranueshmërisë së investimit. Shkalla e investimit ose kushtet e klasifikimit do të formojnë dhe bëjnë pjesë në këtë Rregull në datën e rregulluar me direktivat me shkrim nga BQK-ja që përshkruajnë kërkes(at) e tilla.

Letrat me vlerë të cilat janë të pranueshme (të lejuara) janë në vazhdim:

a *Letrat me vlerë të emetuara dhe/ose të lokalizuara jashtë Kosovës*

Pasuritë pensionale mund të investohen vetëm në llojet ndërkombëtare dhe klasat si në vazhdim:

- Fondet monetare, përfshirë llogaritë bankare dhe depozitat me banka që janë të licensuara nga autoriteti rregullativ banker i një shteti anëtar i OECD-së, dhe licenca e të cilit mbetet në fuqi dhe gjendje të mire;
- Letrat me vlerë të lëshuara nga ndonjë shtet anëtar i OECD-së;
- Letrat me vlerë të lëshuara nga qeveritë vendore në shtetet anëtare të OECD-së në atë masë që të jenë të garantuara nga shteti përkatës;

FONDI SLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE - FUND 1

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015

3. PASURITË E FONDIT 1 DHE STRATEGJIA E INVESTIMIT (VAZHDIM)

- Letrat me vlerë të regjistruara me rregullatorin e tregjeve kapitale të ndonjë shteti anëtar të OECD-së dhe të vendosura për ofertë publike dhe aktivisht të listuara dhe tregtuara në Bursën e Aksioneve që në shtetet e tilla është rregulluar dhe mbikqyrë në mënyrë përkatëse;
- Letrat me vlerë të ndërsjellta ose fondet tjera të investimeve (open end entities) në lidhje me aprovimin e shteteve anëtare të OECD-së për themelimin e tyre dhe për përshtatshmërinë e të cilave kërkesat janë parashikuar nga autoriteti përkatës rregullator dhe mbikqyrës brënda shteteve të tilla anëtare në lidhje me zhvillimin e aktiviteteve të biznesit të entiteteve të tilla "open-end";
- Të gjitha llojet dhe klasët e letrave me vlerë ndërkombëtare që mund të autorizohen, kohë pas kohe, nga ligjet, statutet, rregulloret dhe rregulla efektive të lëshuara nga autoritetet kompetente në Republikën e Kosovës.

b Letrat me vlerë të lëshuara dhe/ose të lokalizuara në Republikën e Kosovës

- Fondet monetare, duke përfshirë llogari bankare dhe depozitat në banka që janë të licensuara nga BQK dhe që zhvillojnë biznes ndërkombëtarë në Republikën e Kosovës në raport të mirë me kërkesat rregullative të BQK-së.

Letrat me vlerë të lëshuara nga autoriteti kompetent në Republikën e Kosovës, në shtrirje të garantuar nga autoriteti i tillë.

- Letrat me vlerë të lëshuara nga ndërmarrjet publike dhe/ose private që janë regjistruar në rregullatorin e tregjeve kapitale në Kosovë duke siguruar se fondet e tilla janë të listuara dhe tregtuar në bursën(at) e letrave me vlerë të listuara në republikën e Kosovës ose në një vend anëtar të OECD-së dhe që janë subjekt të rregullimit dhe mbikqyrjes nga autoriteti i tregut kapital në atë shtet;
- Fondet e ndërsjellta dhe fondet e tjera të ndërsjellta (entitet open-end) që janë subjekte të aprovimit në Kosovë dhe për të cilat kërkesat e përshtatshmërisë janë përshkruar nga autoriteti rregullator dhe mbikqyrës përkatës në Republikën e Kosovës në lidhje me zhvillimin e aktiviteteve biznesore të entiteteve të tilla open-end;
- Të gjitha llojet tjera dhe klasët e letrave me vlerë vendore që mund të autorizohen, kohë pas kohe, nga ligjet, statutet, rregulloret dhe rregullat efektive të lëshuara nga autoritetet kompetente në Republikën e Kosovës.

Fondi 1 duhet gjithashtu të jetë në pajtueshmëri me rregullën mbi investimet e ndaluara të cilat definojnë si më poshtë:

Pasuritë pensionale nuk mund të investohen në llojet në vazhdim:

- Investimet që nuk janë të regjistruara apo nuk tregtohen publikisht;
- Pasuritë të cilat nuk mundën ligjërisht të barten, shiten, hiqen ose në mënyrë tjetër të tjetërsohen;
- Letrat me vlerë derivative, opsionet, pritshmëritë, të përshtatshmet dhe marrëveshjet tjera në lidhje me letrat me vlerë dhe pasuritë tjera financiare;
- Pasuritë e patundshme ose materiale që nuk janë të listuara në tregje të organizuara për të cilat vlerësimi është i pasigurtë duke përfshirë, por duke mos qenë i kufizuar për objektet me vlerë, punimet e artit, antikitetet, monedhat, koleksionet, dhe automjetet;
- Letrat me vlerë të lëshuara nga palët e përshkruara siq janë definuar në këtë Rregull;
- Letrat me vlerë të llojeve që nuk janë të lejuara me rregulloren e pensioneve, këtë rregull dhe/ose letrat me vlerë të siguruara e që nuk janë në pajtim me principet e investimit dhe direktivat e entitetit të pensionit në kohën e përvetësimit të tyre.

Fondet pensionale dhe siguruesit e pensioneve do të konsiderohen në pajtueshmëri me rregullat e shpërndarjes së investimeve nëse kushtet në vijim janë plotësuar:

- Investimet e bëra janë në pajtueshmëri me afatet dhe kushtet që bëjnë pjesë në Deklaratën e tyre të Principeve të Investimeve të aprovuara nga BQK;
- Pasuritë e Fondit Pensional, ose kur aplikohet siguruesit e pensionit, janë mbajtur dhe ruajtur nga Kujdestari në pajtueshmëri me marrëveshjen e kujdestarisë së pasurive;
- Shuma e pasurive nuk tejkalon Pesëqind Mijë (500,000) Euro;
- Fondi Pensional ose Siguruesi i Pensionit ka dorëzuar në BQK një plan të pranueshëm për rritjen e shpërndarjes së investimeve të tij.

FONDI SLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE - FUND 1

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015

4. INSTRUMENTET FINANCIARE SIPAS KATEGORISË

Vlerat bartëse të pasurive financiare dhe detyrimeve të Kompanisë siç janë njohur në datën e pasqyrave financiare nën rishikim mund të kategorizohen siç vijon:

	Në vlerë të drejtë përmes fitimit dhe humbjes	Huatë dhe të arkëtueshmet	Të mbajtura deri në maturim	Gjithsej
31 dhjetor 2015				
Pasuritë				
Paraja dhe ekuivalentët e saj	-	172,560	-	172,560
Letrat me vlerë në dispozicion për shitje	5,146,924	-	-	5,146,924
Letrat me vlerë të mbajtura deri në maturim	-	-	330,306	330,306
Të arkëtueshme të tjera	-	5,020	-	5,020
	5,146,924	177,580	330,306	5,654,810

	Detyrimet tjera financiare me kosto të amortizuar			Gjithsej
Detyrimet				
Detyrimet për taksën e menaxhimit	-	-	9,608	9,608
Detyrimet për ndarjen e fitimit	-	-	7,356	7,356
Detyrimet tjera	-	-	223	223
	-	-	17,187	17,187

	Në vlerë të drejtë përmes fitimit dhe humbjes	Huatë dhe të arkëtueshmet	Të mbajtura deri në maturim	Gjithsej
31 dhjetor 2014				
Pasuritë				
Paraja dhe ekuivalentët e saj	-	116,418	-	116,418
Letrat me vlerë në dispozicion për shitje	4,628,744	-	-	4,628,744
Letrat me vlerë të mbajtura deri në maturim	-	-	741,788	741,788
Të arkëtueshme të tjera	-	180	-	180
	4,628,744	116,598	741,788	5,487,130

	Detyrimet tjera financiare me kosto të amortizuar			Gjithsej
Detyrimet				
Detyrimet për taksën e menaxhimit	-	-	8,412	8,412
Detyrimet për ndarjen e fitimit	-	-	38,519	38,519
Detyrimet tjera	-	-	243	243
	-	-	47,174	47,174

FONDI SLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE - FUND 1

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015

5. PARAJA DHE EKUIVALENTËT E PARASË

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Llogaria rrjedhëse - ABANKA - EUR	77,240	-
Llogaria rrjedhëse - BKT	26,681	3,322
Llogaria e kursimeve - Raiffeisen Bank	22,853	33,048
Llogaria e kontributeve – NLB Kasabank	16,512	14,374
Llogaria e parasë së gatshme - TEB	16,462	5,315
Llogaria e kontributeve – Pro Credit Bank	7,468	10,486
ABANKA - Llogaria rrjedhëse - USD	3,252	-
Llogaria e kontributeve – Banka Ekonomike	2,090	3,284
Banka Ekonomike	2	36
Llogaria e kujdestarisë -Nova Ljubljanska Banka d.d, NLB	-	46,530
Llogaria e parasë së gatshme - Raiffeisen bank	-	23
	172,560	116,418

6. LETRAT ME VLERË NË DISPOZICION PËR SHITJE

Investimet në dispozicion për shitje në deklaratën e pozicionit financiar janë si më poshtë

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Obligacionet e korporatave	1,773,790	2,253,757
Obligacionet qeveritare	1,686,302	1,479,577
Letra me vlerë ekuiteti	1,595,842	750,171
Letrat komerciale	90,990	145,239
	5,146,924	4,628,744

Tabela ne vazhdim paraqet lëvizjen e letrave me vlerë të mbajtura për tregtim gjatë vitit 2015 dhe 2014:

	Obligacionet e korporatave	Obligacionet Qeveritare	Letrat komerciale	Letrat me vlerë ekuiteti	Gjithsej
Më 01 janar 2015	2,253,757	1,479,577	145,239	750,171	4,628,744
Shtesat	436,159	938,467	193,179	798,328	2,366,133
Shitje/maturim	(775,101)	(736,163)	(248,429)	-	(1,759,693)
Ndryshimi neto në kursin valutor	-	-	-	71,070	71,070
Fitimi/humbja e perealizuar	(141,025)	4,421	1,001	(23,727)	(159,330)
Më 31 dhjetor 2015	1,773,790	1,686,302	90,990	1,595,842	5,146,924
Më 01 janar 2014	2,471,528	819,409	99,513	379,163	3,769,613
Shtesat	921,844	885,179	290,688	349,025	2,446,736
Riklasifikuar	(1,133,641)	(285,287)	(248,501)	(44,165)	(1,711,594)
Ndryshimi neto në kursin valutor	-	-	-	32,852	32,852
Fitimi/humbja e perealizuar	(5,974)	60,275	3,538	33,298	91,137
Më 31 dhjetor 2014	2,253,757	1,479,576	145,238	750,173	4,628,744

FONDI SLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE - FUND 1

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015

7. INVESTIMET E MBAJTURA DERI NË MATURIM

Letrat me vlerë të mbajtura deri në maturim përbëjnë tërësisht obligacionet dhe letrat tjera me vlerë të borxhit të emetuara nga kompanitë e huaja dhe bankat.

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Depozitat në banka	307,900	634,501
Interesi i përlllogaritur (akruar)	22,406	107,287
	330,306	741,788

Depozitat në banka dhe interesi i përlllogaritur është si vijon:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Banka Kombetare Tregtare BKT	161,276	121,986
TEB –Turkish Enterprise Bank	115,751	155,862
Raiffeisen Bank	53,279	87,737
Pro Credit Bank PCB	-	198,773
Banka Ekonomike e Kosovës	-	98,402
NLB Kasabank	-	79,028
	330,306	741,788

Depozitat në banka fitojnë interes prej 3% deri 6.6% në baza vjetore. Periudha e maturimit të tyre varion nga 1 deri 5 vjet.

8. DETRYIMET PËR NDARJEN E FITIMIT

Kompania ka shpërblyer menaxherin e pasurive në baze të planit pensional "Në rast se fondi performon më mirë se sa kufiri i përcaktuar në aktin e brendshëm atëherë menaxheri i pasurive ka të drejtë të shpërblehet deri në 20% të mbikufirit të të ardhurave".

Kthimi i Fondit është themeluar çdo vit më 30 nëntor, periudha kontabël është i një viti. Plani pensional i kompanisë për kthimin e fondeve është miratuar nga Banka Qëndrore.

9. TË HYRAT NGA INTERESI

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Të hyrat nga interesi i letrave me vlerë	141,993	145,399
Të hyrat nga interesi në depozita	21,830	52,567
Të hyrat nga interesi në llogari bankare	16	67
	163,839	198,033

10. FITIMI I REALIZUAR NGA SHITJA/MATURIMI I INVESTIMEVE NË LETRA ME VLERË

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Obligacionet qeveritare	21,930	15,566
Obligacionet e korporatave	306	3,971
Letrat komerciale	3,571	3,791
Aksionet e ekuitetit	-	5,145
	25,807	28,473

FONDI SLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE - FUND 1

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015

11. TRANSAKSIONET ME PALËT E LIDHURA

Palët e lidhura përfshijnë aksionarët kryesorë, bashkimet dhe entitetet nën pronësi të përbashkët, kontrollin dhe menaxhimin e Fondit, apo aktivitetet e të cilave Fondi ka kompetencën për ti kontrolluar.

Të gjitha transaksionet e Fondit me palët e lidhura dalin nga rrjedha normale e biznesit dhe vlera e tyre nuk është materialisht e ndryshe nga afatet dhe kushtet që do të i zotëronin në transaksione të vullnetit të lirë. Të gjitha transaksionet e palëve të lidhura dhe balancet i referohen Kompanisë, FSKP-së dhe janë si në vazhdim:

31 dhjetor 2015	Prva Group	Kompania	Fond 2	Gjithsej
Të arkëtueshmet				
Të arkëtueshmet nga Kompania	-	1,100	-	1,100
Gjithsej të arkëtueshmet	-	1,100	-	1,100
Detyrimet				
Detyrimet për ndarjen e fitimit	7,356	-	-	7,356
Detyrimet për tarifën e menaxhimit	-	9,384	-	9,384
Detyrimet	-	-	224	224
Gjithsej Detyrimet	7,356	9,384	224	16,964
Të arkëtueshmet neto/(detyrimet)	(7,356)	(8,284)	(224)	(15,864)
Shpenzimet				
Shpenzimet për ndarjen e fitimit	7,356	-	-	7,356
Shpenzimet për tarifën e menaxhimit	-	103,521	-	103,521
Gjithsej shpenzimet	7,356	103,521	-	110,877
Neto e ardhura/(shpenzimet)	(7,356)	(103,521)	-	(110,877)
31 dhjetor 2014				
Detyrimet				
Detyrimet për ndarjen e fitimit	38,519	-	-	38,519
Detyrimet për tarifën e menaxhimit	-	-	8,412	8,412
Gjithsej detyrimet	38,519	-	8,412	46,931
Të arkëtueshmet neto/(detyrimet)	(38,519)	-	(8,412)	(46,931)
Shpenzimet				
Shpenzimet për ndarjen e fitimit	38,519	-	-	38,519
Shpenzimet për tarifën e menaxhimit	-	-	96,754	96,754
Gjithsej shpenzimet	38,519	-	96,754	135,273
Neto e ardhura/(shpenzimet)	(38,519)	-	(96,754)	(135,273)

FONDI SLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE - FUND 1

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015

12. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR

Aktivitetet e Fondit e ekspozojnë atë ndaj disa risqeve financiare dhe këto aktivitetet përfshijnë analizat, vlerësimin, pranimin dhe menaxhimin e risqeve. Synimi i Fondit është që të arrijë një balanc të përshtatshëm ndërmjet riskut dhe kthimit dhe të minimizojë kundër efektet e mundshme mbi performancën financiare të Fondit.

Politikat e Fondit për menaxhimin e riskut janë dizajnuar për të identifikuar dhe analizuar këto risqe, për të vënë limitet e duhura dhe kontrole të riskut, dhe për të monitoruar risqet dhe zbatimin e limiteve me anë të mjeteve të sistemit informative të besueshëm dhe modern. Menaxhmenti i Fondit rregullisht rishikon politikat dhe sistemet e menaxhimit të riskut për të reflektuar ndryshimet në tregje, produkte dhe praktikata më të mira që dalin.

Menaxhimi i riskut bartet nga Departamenti i Menaxhimit të Riskut nën politikat e aprovuara nga Kompania. Ky departament identifikon dhe vlerëson riskun financiar në bashkpunim të ngushtë me njësitë operative të Fondit. Fondi ofron parime të shkruara për menaxhimin e përgjithshëm të riskut, si dhe politika të shkruara që mbulojnë fusha specifike, si risku i këmbimeve të huaja, risku i normës së interesit dhe risku kreditor.

Risku kreditor

Fondi merr pjesë në ekspozimin ndaj riskut kreditor, i cili është një rrezik që një palë e kundërt do të shkaktojë humbje për Fondin duke dështuar në shlyerjen e obligimit. Risku kreditor është risku më i rëndësishëm për aktivitetet biznesore të Fondit. Prandaj, menaxhmenti i Fondit me kujdes menaxhon ekspozimin ndaj riskut kreditor. Fondi duhet të jetë në përputhje me rregullat e BQK-së për sa i përket llojeve dhe shumave të investimeve në pasuritë financiare.

	2015	2014
Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut të kredisë		
Letrat me vlerë të mbajtura për tregëtim		
Obligacionet e korporatave	1,773,790	2,253,757
Obligacionet e korporatave	1,686,302	1,479,577
Letrat me vlerë të ekuitetit	1,595,842	750,171
Faturat komerciale	90,990	145,239
	5,146,924	4,628,744
Letrat me vlerë të mbajtura deri në maturim		
Depozitat në banka	307,900	634,501
Interesi i përllogaritur (akruar)	22,406	107,287
	330,306	741,788
Të arkëtueshmet tjera		
	5,020	180
	5,482,250	5,370,712

FONDI SLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE - FUND 1

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015

12. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

Rreziku i normës së interesit

Tabela e mëposhtme analizon pasuritë dhe detyrimet e Fondit në grupime relevante të maturimit duke u bazuar në periudhën e mbetur në datën e pozicionit financiar deri te data e maturimit të kontraktuar, për 31 dhjetor 2015 dhe 2014 (në Euro).

31 dhjetor 2015

	Që bartin interes					Që nuk bartin interes	Gjithsej
	Më pak se 1 muaj	1 deri në 3 muaj	3 deri në 12 muaj	1 deri në 5 vite	Mbi 5 vite		
<i>Pasuritë</i>							
Paraja dhe ekuivalentet e parasë	172,560	-	-	-	-	-	172,560
Letrat me vlerë në dispozicion për shitje	-	109,949	458,560	1,777,064	1,114,520	1,686,831	5,146,924
Letrat me vlerë të mbajtura deri në maturim	-	115,752	-	214,554	-	-	330,306
Të arkëtueshmet tjera	-	-	-	-	-	5,020	5,020
	172,560	225,701	458,560	1,991,618	1,114,520	1,691,851	5,654,810
<i>Detyrimet</i>							
Detyrimet për tarifën e menaxhimit	-	-	-	-	-	9,608	9,608
Detyrimet për ndarjen e fitimit	-	-	-	-	-	7,356	7,356
Detyrime të tjera	-	-	-	-	-	223	223
	-	-	-	-	-	17,187	17,187
Hendeku në neto riskun e interesit	172,560	225,701	458,560	1,991,618	1,114,520	1,674,664	5,637,623
31 dhjetor 2014							
Pasuritë	116,418	400,318	560,111	2,477,834	1,182,098	750,351	5,487,130
Detyrimet	-	-	-	-	-	47,174	47,174
Hendeku në neto riskun e interesit	116,418	400,318	560,111	2,477,834	1,182,098	703,177	5,439,956

Risku i valutës së huaj

Më 31 dhjetor 2015 dhe 2014, Fond 1 është ekspozuar riskut duke marrë parasysh efektet nga rrjedha e parasë të normës së nivelit të këmbimit valutator. Tabelat në vijim përmbledhin pozicionin e riskut valutator të pasurive monetare dhe detyrimeve të Fondit më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 (në Euro):

31 dhjetor 2015	Në EUR	Në USD	Valuta tjera	Gjithsej
Pasuritë				
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	169,308	3,252	-	172,560
Letrat me vlerë në dispozicion për shitje	3,959,471	1,187,453	-	5,146,924
Letrat me vlerë të mbajtura deri në maturim	330,306	-	-	330,306
Të arkëtueshmet tjera	5,020	-	-	5,020
Gjithsej pasuritë	4,464,105	1,190,705	-	5,654,810
Detyrimet				
Detyrime për tarifën e menaxhimit	9,608	-	-	9,608
Detyrime për ndarjen e fitimit	7,356	-	-	7,356
Detyrime të tjera	223	-	-	223
Gjithsej detyrimet	17,187	-	-	17,187
Risku i valutës së huaj neto	4,446,918	1,190,705	-	5,637,623
31 dhjetor 2014				
Gjithsej pasuritë	5,065,246	421,884	-	5,487,130
Gjithsej detyrimet	47,174	-	-	47,174
31 dhjetor 2014	5,018,072	421,884	-	5,439,956

FONDI SLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE - FUND 1

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015

12. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

Risku i likuiditetit

Politika e Fondit 1 është të investojë pasuritë në instrumentet e larta likuide financiare në tregje të ndryshme kapitale në përputhshmëri me kufizimet e përshkruara nga Ligji dhe Rregulloret. Gjatë procesit të krijimit të portfolios së Fondit, duke u munduar të sigurojmë likuiditet të lartë, pasuritë e Fondit janë investuar në letra me vlerë të karakterizuara me mundësinë e shkëmbimit të shpejtë në para dhe ekuivalente të parasë.

Tabela në vazhdim analizon pasuritë dhe detyrimet e Fondit në maturim relevant duke u bazuar në periudhën e mbetur në datën e bilancit të gjendjes deri në datën e kontraktuar të maturimit (në Euro).

31 dhjetor 2015	Më pak se 1 muaj	Nga 1 deri 3 muaj	Nga 3 deri 12 muaj	Nga 1 deri 5 vjet	Më shumë se 5 vjet	Gjithsej
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	172,560	-	-	-	-	172,560
Letrat me vlerë në dispozicion për shitje	-	127,881	531,617	1,777,064	2,710,362	5,146,924
Letrat me vlerë të mbajtura deri në maturim	-	115,752	-	214,554	-	330,306
Të arkëtueshmet tjera	5,020	-	-	-	-	5,020
	177,580	243,633	531,617	1,991,618	2,710,362	5,654,810
<i>Detyrimet</i>						
Detyrimet për tarifën e menaxhimit	9,608	-	-	-	-	9,608
Detyrimet për ndarjen e fitimit	7,356	-	-	-	-	7,356
Detyrimet tjera	223	-	-	-	-	223
	17,187	-	-	-	-	17,187
Hendeku i neto likuiditetit	160,393	243,633	531,617	1,991,618	2,710,362	5,637,623
31 dhjetor 2014						
Gjithsej pasuritë	116,598	400,318	560,111	2,477,834	1,932,269	5,487,130
Gjithsej detyrimet	47,174	-	-	-	-	47,174
Hendeku i neto likuiditetit	69,424	400,318	560,111	2,477,834	1,932,269	5,439,956

13. VLERA E DREJTË

Vlera e drejtë përfaqëson shumën me të cilën një pasuri mund të zëvendësohet ose një detyrim të shlyhet në transaksion duar lirë. Vlera e drejtë është bazuar në supozimet e menaxhmentit sipas fitimit të pasurisë dhe bazës së detyrimit.

Instrumentet financiare të prezentuara me vlerën e drejtë

Pasuritë financiare të llogaritura sipas vlerës së drejtë në pasqyrën e pozicionit financiar në përputhshmëri me hierarkinë e vlerës së drejtë janë të paraqitura në tabelën vijuese. Kjo hierarki mbledh pasuritë financiare dhe detyrimet në tri nivele që bazohen në rëndësinë e të dhënave të ardhura të përdorura gjatë matjes së vlerës së drejtë të pasurive financiare

- **Niveli 1:** çmimet e kuotuar (jo të rregulluara) në tregjet aktive për pasuritë identike ose detyrimet;
- **Niveli 2:** të dhëna hyrëse të tjera, përveç prej, çmimeve të kuotuar, të përfshira në nivelin 1 që janë të gatshme për vëzhgim të pasurisë ose të detyrimit, direkt (p.sh. si çmime), ose indirekt (p.sh. të bëra nga çmimet) dhe
- **Niveli 3:** të dhënat hyrëse në pasuri ose detyrim që nuk janë të bazuara në të dhëna të gatshme për vëzhgim të tregut.

Pasuritë financiare që janë regjistruara sipas vlerës së drejtë në pasqyrën e Fondit 1 të pasurive neto janë mbledhur sipas nivelit të hierarkisë së vlerës reale, siq vijon (në Euro).

31 dhjetor 2015

	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Gjithsej
Pasuritë				
Letrat me vlerë në dispozicion për shitje	5,146,924	-	-	5,146,924
Letrat me vlerë të mbajtura deri në maturim	-	330,306	-	330,306

FONDI SLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE - FUND 1

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015

12. VLERA E DREJTË (VAZHDIM)

Instrumentet financiare që nuk janë prezentuar në vlerë të drejtë

31 dhjetor 2014

	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Gjithsej
Pasuritë				
Letrat me vlerë në dispozicion për shitje	4,628,744	-	-	4,628,744
Letrat me vlerë të mbajtura deri në maturim		741,788	-	741,788

Tabela në vijim përmbledh vlerat bartëse dhe vlerën e drejtë të atyre pasurive financiare dhe detyrimeve që nuk janë prezentuar në pozicionin financiar tek vlera e drejtë.

	Vlera bartëse		Vlera e drejtë	
	2015	2014	2015	2014
Pasuritë				
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	172,560	116,418	172,560	116,418
Letrat me vlerë të mbajtura deri në maturim	330,306	741,788	330,306	741,788
Të arkëtueshme të tjera	5,020	180	5,020	180
Gjithsej pasuritë	507,886	858,386	507,886	858,386

Detyrimet

Detyrimet për tarifën e menaxhimit dhe detyrime të tjera	17,187	47,174	17,187	47,174
Gjithsej detyrimet	17,187	47,174	17,187	47,174

Vlera e drejtë e instrumenteve financiare të tregtuara në tregje aktive (siq janë letrat me vlerë të tregtueshme dhe në dispozicion për shitje) është e bazuar në çmimet e kuotuar të tregut në datën e pozicionit. Çmimi i kuotuar i tregut i përdorur për pasuritë financiare të mbajtura nga Fondi është çmimi aktual i ofertimit.

Vlera reale e instrumenteve financiare që nuk janë tregtuar në tregje aktive është përcaktuar duke përdorur teknikat e vlerësimit.

Vlerat bartëse minus provisioni për dëmtimin e të arkëtueshmeve tregtare si dhe vlera bartëse e të pagueshmeve supozohet se përfaqsojnë vlerat e tyre reale. Vlera reale e detyrimeve financiare për qëllime të shpalosjes është vlerësuar duke zbritur rrjedhat e ardhshme të parasë së kontraktuar në normën e interesit aktuale në treg që është në dispozicion të fondit për instrumente të ngjashme financiare. Megjithatë, për vendosjet bankare afatshkurtra ku normat e interesit janë të krahasueshme në treg, vlera kontabël është konsideruar të jetë përafërimi më i mirë i vlerës së drejtë.

14. NGJARJET PASUESE PAS DATËS SË RAPORTIMIT

Pas 31 dhjetorit 2015 datë raportimi deri në miratimin e këtyre raporteve financiare, nuk ka ngjarje rregulluese që janë pasqyruar në pasqyrat financiare apo ngjarje që janë materialisht të rëndësishme për zbulimin e këtyre pasqyrave financiare.